

VENDIM
Nr. 761, datë 5.9.2013

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE KOMUNA VËRTOP, BERAT, TË SIPËRFAQES 12969 M², NGA TRUALLI FUNKSIONAL I PRONËS NR. 1029, ME EMËRTIM “ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5013”, VËRTOP, BERAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Vërtop, Berat, të sipërfaqes 12 969 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 1029, me emërtim “Ish-Reparti Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Vërtop, Berat, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike në interes të komunitetit për ndërtimin e rrugës Ura e Vërtopit - fshati Drenovë.

2. Sipërfaqja 12 969 (dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m², pjesë e pronës nr. 1029, me emërtim “Ish-Reparti Ushtarak nr. 5013”, me vendndodhje në Vërtop, Berat, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komunës Vërtop i ndalohet të ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së përmendur në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Komuna Vërtop, në pjesën ku kufizohet rruga me repartin, pronë e Ministrisë së Mbrojtjes, të bëjë sistemimin e dherave nëpërmjet ndërtimit të mureve pritëse e mbajtëse, si dhe ndërtimin e gardhit rrethues të saj.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i komunës Vërtop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha